

UDHËZIM
Nr. 4160, datë 12.9.2006

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.555, DATË 16.8.2006 “PËR KTHIMIN E FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET QË PËRFITOJNË NGA PËRDORIMI I FONDIT KUNDËRPARTI TË GRANTEVE JAPONEZE, PËR PROJEKTIN “RRITJA E PRODHIMIT USHQIMOR 2KR” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET NR.479, DATË 19.7.2001, NR.373, DATË 5.6.2003 DHE NR.114, DATË 25.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 11/1, datë 31.10.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 16.8.2006 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet që përfitojnë nga përdorimi i fondit kundërparti të granteve japoneze, për projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” dhe për një ndryshim në vendimet nr. 479, datë 19.7.2001, nr. 373, datë 5.6.2003 dhe nr. 114, datë 25.2.2005 të Këshillit të Ministrave”, Ministri i Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Të gjitha subjektet përfituese, që janë financuar nga njësia e menaxhimit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, për periudhën nga 1999 e në vazhdim, të lidhin kontratë me “Projektin 2KR” për mallrat, pajisjet, linjat teknologjike të agropërpunimit dhe serat me ngrohje.

2. Autorizohet drejtori i “Projektit 2KR”, për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave me subjektet përfituese.

3. Vlera financiare e përfituar për mallrat, pajisjet, linjat teknologjike dhe serat me ngrohje, që janë financuar nga “Non Projekt Grant Aid” dhe përdorimi i fondit kundërparti në kuadër të granteve japoneze, të shlyhen si fonde kundërparti nga subjektet përfituese me këste, pa interes, me vlerën e barasvlefshme në “lekë” të çmimit të blerjes FOB, brenda një afati prej shtatë vjetësh, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim. Konvertimi në lekë i çmimit të blerjes FOB të bëhet sipas kursit zyrtar të këmbimit të valutës në lekë, në datën e marrjes në dorëzim të mallrave, pajisjeve, linjave dhe serave me ngrohje.

4. Për mallrat, pajisjet, linjat teknologjike dhe serat me ngrohje, të cilat janë marrë në dorëzim para daljes së këtij udhëzimi, detyrimi të llogaritet në mënyrë proporcionale për periudhën e mbetur nga data e lidhjes së kontratës, duke respektuar pikën 3 të këtij udhëzimi.

5. “Projektin 2KR” lidh kontratë me subjektet përfituese brenda një afati 2-mujor nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

6. Diferencat financiare ndërmjet çmimeve CIF dhe FOB, të evidentohen nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” në pakësim të fondeve kundërparti.

7. Brenda strukturës organizative të miratuar të sektorit të fondit kundërparti drejtori i projektit ngarkon specialistë të veçantë për monitorimin, menaxhimin e linjave dhe kthimin e fondit kundërparti nga çdo subjekt. Këta specialistë mbajnë dokumentacion të plotë dhe ndjekin punën për shlyerjen e vlerës së përcaktuar të mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit dhe serave me ngrohje.

8. “Projektin 2KR”, në bashkëpunim me organet tatimore, ka të drejtë të ushtrojë kontroll teknik e financiar mbi veprimtarinë ekonomike që subjekti kryen, gjendjen teknike etj. për sa kohë që nuk është paguar kësti i fundit.

9. Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë e të japë informacion në “Projektin

2KR” për të dhënat që i kërkojnë prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.

10. Numri i kësteve për çdo vit kalendarik do të jetë 2-3, gjë që do të pasqyrohet në kontratë.

11. Kuota e arkëtimit të kështit të parë në llogarinë e “Projektit 2KR” të jetë jo më pak se vlera e çdo kësti caktuar sipas pikës 10 të këtij udhëzimi.

Subjekti përfitues mund të bëjë në çdo kohë likuidim të menjëhershëm të disa kësteve, kjo e parashikuar në kontratën ndërmjet palëve.

12. *Për rastet e mospagimit në kohë të kështit, subjekti përfitues i mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit dhe serave me ngrohje, penalizohet me një kamatëvonesë 5% në vit të vlerës së kështit të papaguar, e llogaritur kjo për çdo ditë pune deri në ditën e kryerjes së pagesës.*

13. Kur subjekti përfitues, pagues i rregullt i kësteve nuk paguan dy këste të radhës të cilat janë të pasqyruara në kontratë, mallrat, pajisjet, linjat e agropërpunimit dhe serat me ngrohje sekuestrohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pa asnjë rimbursim të kësteve të mëparshme.

14. Subjekti përfitues që nuk paguan asnjë këst apo nuk bie dakord ta nënshkruajë kontratën me “Projektin 2KR”, mallrat, pajisjet, linja e agropërpunimit ose serat me ngrohje që ka përfituar sekuestrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njëkohësisht ndaj këtyre subjekteve bëhet kallëzim penal pranë prokurorisë.

15. Për pikat 13 dhe 14 të këtij udhëzimi, drejtori i “Projektit 2KR” urdhëron sekuestrimin e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit ose serës me ngrohje. Ky urdhër përbën titull ekzekutiv.

16. Në rast sekuestrimi, organet kompetente bllokojnë veprimtarinë ekonomike të subjektit dhe “Projekti 2KR” planifikon punën për çmontimin e linjës (serës) dhe rishpërndarjen e saj në subjekte të reja përfituese, duke respektuar udhëzimin në fuqi.

17. Kalimi i pronësisë së mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serës me ngrohje nga “Projekti 2KR” te subjekti përfitues, bëhet vetëm pasi ky i fundit të ketë likuiduar edhe kështin e fundit në përputhje me kontratën duke shlyer vlerën FOB të linjës apo serës.

Në këtë rast “Projekti 2KR” i kalon pronësinë subjektit përfitues duke e pajisur atë me “Vërtetim pronësie”.

18. Për rastet e patrajtuara nga ky udhëzim, nëse gjykohet për efekt të faktorëve objektive, me propozim të drejtorit të “Projektit 2KR”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit përcakton mënyrën e zgjidhjes me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode